



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI**

Nr. 1565 Prot.

Tiranë, më 14.05.2020

KËRKESË

KËRKUES:

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Adresa: Godina e Institucionit të Presidentit të Republikës,
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë

DREJTUAR:

**GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE, me adresë: Bulevardi
“Dëshmorët e Kombit”, Godina e Kryeministrit, Tiranë

MINISTRIA E KULTURËS, me adresë: Rruga
“Aleksandër Moisiu”, nr. 76, ish-Kinostudio “Shqipëria e
Re”, Tiranë

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË me
adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.3, Tiranë

BASHKIA E TIRANËS me adresë: Sheshi “Skënderbej”,
nr. 12, Tiranë

OBJEKTI:

Shfuqizimin të Vendimit nr.377, datë 8.5.2020 të Këshillit të
Ministrave “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të
pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën
kadastrale 8150, Tiranë”, si të papajtuësëm me Kushtetutën
dhe me Marrëveshjet Ndërkombëtare.

Pezullimin e zbatimit të Vendimit nr. 377, datë 8.5.2020, të
Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi të Bashkisë
Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”,
në zonën kadastrale 8150, Tiranë”, dhe qëllimit të përcaktuar
në këtë akt, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese

mbi këtë çështje dhe mbi çështjen tjetër në shqyrtim, që lidhet me kundërshtimin e ligjit nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”, të hyjë në fuqi.

BAZA LIGJORE:

Nenet 3, 4/1, 5, 6, 7, 59 paragrafi 1, nënparagrafi “g”, 86/1, 116/1, 122, 124, 131 pika 1, germa “c”, 132/2, 134 paragrafi 1 nënparagrafi “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Nenet 20, 21/1, 26, 27, 42, 45, 47, 49/1, 50/1, 51, 51/a, pika 1, germa “b”, 76, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ligji nr. 9490, datë 13.03.2006 “Për ratifikimin e Konventës për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”, miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën, “UNESCO”, në Paris më datë 17 tetor 2003;

Ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe bashkësive evropiane e shteteve të tyre anëtare”;

Të nderuar anëtarë të Gjykatës Kushtetuese,

I. Përmbledhje e fakteve

1. Presidenti i Republikës me shkresën nr. 2580 prot., datë 24.07.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës pretendimin kushtetues me objekt:

“Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe me Marrëveshjet Ndërkombëtare të ligjit nr. 37/2018 ‘Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës’ me objekt ‘Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar’.

Pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 37/2018 ‘Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës’ me objekt ‘Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar’, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese mbi këtë çështje të hyjë në fuqi.”

Ky kërkim është administruar në Gjykatën Kushtetuese me Nr. P-3, datë 24.07.2019.

2. Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese datë 24.07.2019¹, Presidenti i Republikës, në cilësinë e palës kërkuese në këtë gjykim, ka kërkuar shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjit nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”, i miratuar nga Kuvendi në datë 05.07.2018 dhe në datë 20.09.2018, si një akt ligjor i cili:

- nuk është në përputhje me parimet themelore kushtetuese;
- bie ndesh drejtpërdrejtë me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- cenon rëndë identitetin dhe trashëgiminë tonë kombëtare;
- nuk garanton mbrojtjen e pronës publike;
- cenonte parimin e sigurisë juridike lidhur me ushtrimin e të drejtave pronësore mbi të drejtat private të pronësisë;
- është në kundërshtim me sistemin ligjor aktual, mbi të cilin zhvillohet shoqëria shqiptare;
- bie ndesh me aktet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë aderon apo i ka ratifikuar;
- binte ndesh me përcaktimet e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit;
- dispozitat e këtij ligji përmbanin kritere diskriminuese që nuk garantonin konkurrencën e lirë dhe binin ndesh me zbatimin e parimeve kushtetuese të “barazisë përpara ligjit” dhe “lirisë së veprimtarisë ekonomike të shtetasve”, duke cenuar kështu funksionimin e shtetit të së drejtës;
- cenonte rëndë parimet kushtetuese të ndërtimit dhe funksionimit të organeve të pushtetit vendor të “decentralizimit” dhe “autonomisë vendore”, duke rënë ndesh njëkohësisht, edhe me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve;
- binte në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese të krijuar nga Gjykata Kushtetuese, mbi parimet e funksionimit të organeve të qeverisjes vendore dhe ushtrimit të kompetencave prej tyre në përputhje me parimin e decentralizimit dhe autonomisë vendore;
- paraqiste mangësi dhe paqartësi të theksuara në aspektin e leverdisë ekonomike dhe financiare të shtetit, duke krijuar terren të përshtatshëm për abuzim me pronën publike dhe cenimin e interesit publik.

3. Presidenti i Republikës, kërkoi nga ana e Gjykatës Kushtetuese, përcaktimin e një date sa më të afërt për shqyrtimin e kërkesës **për pezullimin e zbatimit të ligjit**, pasi siç po evidentohet në mënyrë të qartë dhe publikisht, subjektet e interesuara palë në këtë proces, Bashkia Tiranë, Këshilli i Ministrave, Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ishin duke vijuar me procedurat në zbatim të këtij ligji antikushtetues, të cilat parashikonin dhe sillnin si pasojë prishjen e kompleksit të godinave të Teatrit Kombëtar.

¹Konsulto *link*-un: <http://president.al/presidenti-meta-depoziton-kerkesen-per-shpalljen-antikushtetues-te-ligjit-per-shembjen-e-teatrit-kombetar-ne-gjykatën-kushtetuese/>

4. Gjykata Kushtetuese përmes **nr. 4 Akti, datë 30 dhjetor 2019**, “Njoftim për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare dhe vijueshmërisë së saj”, ka informuar Presidentin e Republikës së Kolegji i Gjykatës Kushtetuese **më datë 24.12.2019**, ka vendosur kalimin për shqyrtim në seancë plenare me dyer të hapura të kërkesës së Presidentit të Republikës nr. 2580 prot., datë 24.07.2019, me objekt:

“Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe me Marrëveshjet Ndërkombëtare të ligjit nr. 37/2018 ‘Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës’ me objekt ‘Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar’.

Pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 37/2018 ‘Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës’ me objekt ‘Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar’, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese mbi këtë çështje të hyjë në fuqi.”

5. Në shkresën **nr. 4 Akti, datë 30 dhjetor 2019**, Gjykata Kushtetuese informon gjithashtu Presidentin e Republikës se data e seancës do të caktohet në një moment të dytë, sapo Gjykata Kushtetuese të ketë kuorumin e nevojshëm për shqyrtimin e kërkesës në seancë plenare, sipas nenit 31 pika 1 të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar. Gjykata përmes kësaj shkrese njoftonte Presidentin që nëse e çmonim të nevojshme kishim mundësinë e paraqitjes së komenteve me shkrim apo argumente shtesë brenda datës **22 janar 2020**.

6. Përmes Aktit nr. 2580/5 Prot, datë 21.01.2020, Presidenti i Republikës i ka paraqitur Gjykatës Kushtetuese argumente shtesë, duke i parashtruar gjithashtu kërkesën për përcaktimin e një date sa më të afërt për shqyrtimin e **kërkesës për pezullimin e zbatimit të ligjit**, pasi siç po evidentohet në mënyrë të qartë dhe publikisht, subjektet e interesuara palë në këtë proces, Bashkia Tiranë, Këshilli i Ministrave, Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ishin duke vijuar me procedurat në zbatim të këtij ligji antikushtetues, të cilat parashikonin të **sillnin si pasojë prishjen e kompleksit të godinave të Teatrit Kombëtar**.

7. Në këto argumente shtesë të paraqitura në datën 21 janar 2020, Presidenti i Republikës, i ka parashtruar Gjykatës Kushtetuese se: *“Nëse Teatri do të prishej para vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, atëherë pasojat do të ishin të parikuperueshme. Kjo bën të domosdoshme që **pezullimi të vendoset dhe të zgjasë derisa vendimi i Gjykatës Kushtetuese të marrë fuqi.**”*

8. Në këtë shkresë, Presidenti i Republikës, veç të tjerave, ka vënë në dijeni Gjykatën Kushtetuese se shqetësimi për vijimin e procedurës që vlerësohet tërësisht antikushtetuese, është përcjellë nga shumë aktorë, përfshirë dhe nga Presidenti Ekzekutiv i Lëvizjes për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore “Europa Nostra”, lëvizje kjo që ka bërë thirrje për të mbrojtur *“të çmuarin Teatër Kombëtar”*, që është nominuar si pjesë e fushatës së shoqërisë civile në Evropë, për mbrojtjen e vendndodhjeve më të rrezikuara për vitin 2020, duke i vendosur në dispozicion Gjykatës Kushtetuese edhe letrën e datës 17 janar 2020 që Presidenti

Ekzekutiv i Lëvizjes për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore “Europa Nostra” i drejton Presidentit të Republikës, Kryeministrin dhe Kryetarit të Bashkisë Tiranë në Republikën e Shqipërisë.

9. Ndërkohë që edhe palët e interesuara: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë i kanë parashtruar Gjykatës Kushtetuese argumentet e tyre, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës së Presidentit të Republikës.

10. Në datën **22 janar 2020**, Bashkia Tiranë, me shkresën e saj nr. 3394 prot., ka përcjellë shpjegimet e veta me shkrim pranë Gjykatës Kushtetuese për kërkesën e Presidentit të Republikës. Institucioni i Presidentit të Republikës ka marrë dijeni për këto argumente përmes shkresës nr. 4 Akti, datë 23.01.2020 të Gjykatës Kushtetuese, administruar në institucion me nr. 383 prot., datë 24.01.2020.

10.1. Mes parashtrësive të Bashkisë Tiranë në drejtim të Gjykatës Kushtetuese, argumentohet fakti se, në vetvete ligji nr. 37/2018, objekt shqyrtimi gjyqësor sipas kërkesës së Presidentit të Republikës, ishte *“një ligj procedural ku sanksionohet procedura e shprehjes së interesit dhe faza kualifikues edhe vlerësuese për palët private që kanë shprehur interes. Ky ligj nuk sillte asnjë pasojë që mund të përbënte një situatë të jashtëzakonshme, përderisa për miratimin e kontratës midis palës shtet dhe asaj private, është parashikuar miratimi me një ligj tjetër të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe deri në atë moment, nuk kemi asnjë pasojë konkrete që mund të vijë për nisjen e zhvillimit të projektit urban.”*

10.2. Pra në pretendimet e saj, Bashkia Tiranë evidenton faktin se Presidenti i Republikës do të kishte sërish mundësinë për t’u shprehur, pasi të finalizohet projekti i nisur përmes nënshkrimit të marrëveshjes që do të miratohej nga Kuvendi me ligj e që do të duhej të rishqyrtohej nga Presidenti përmes dekretit. Ndërkohë që sipas aktit objekt kundërshtimi, ky argument i Bashkisë Tiranë bie, pasi përmes VKM-së nr. 377/2020, tashmë nuk është i nevojshëm as shprehja e vullnetit të ligjvënësit.

11. Përkundër pretendimeve të tyre të parashtruara përpara Gjykatës Kushtetuese më datë 26 shkurt 2020, në median e shkruar dhe elektronike, bëhet publik lajmi se Bashkia e Tiranës do të ndërtojë me fonde publike Teatrin e ri Kombëtar. Në mungesë të ndonjë komunikimi zyrtar lidhur me këtë proces apo të ndonjë akti zyrtar (ligj apo vendim të Kuvendit, Këshillit të Ministrave apo Bashkisë Tiranë) kemi konstatuar të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë vetëm deklaratën e kësaj Bashkie, në seksionin e lajmeve, me përmbajtje si më poshtë:

“Në mbështetje të ligjit nr. 37/2018 dhe vendimit nr.352, datë 04.04.2019 të Këshillit të Ministrave, pranë Bashkisë Tiranë u ngrit komisioni për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”, në përbërje të të cilit ishte edhe përfaqësia e artistëve.

Komisioni i vlerësimit dhe negocimit nisi punën me hartimin e thirrjes së hapur për palët private të interesuara, për të marrë pjesë në këtë procedurë konkurruese dhe paraqitjen e një oferte financiare për ndërtimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar dhe zhvillimin e zonës urbane. Thirrja e hapur u publikua në faqen zyrtare të Bashkisë së Tiranës, si dhe u dërgua për botim në buletin zyrtar të Agjencisë së Prokurimeve Publike.

Pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave, komisioni i vlerësimit, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nën ekspertizën konsulentit të përzgjedhur për të ndihmuar komisionin, nisi punën me negocimin e ofertës së palës private të interesuar.

Komisioni i negocimit, në mbështetje të të gjitha kërkesave të komunitetit të artistëve për një teatër modern, i cili përmbush kriteret e nevojshme për realizimin profesional e me cilësi të shfaqjeve teatrale, nuk arriti të gjejë dakordësinë me palën private. Modeli financiar i propozuar nga pala private e interesuar për ndërtimin e godinës së Teatrit të ri Kombëtar dhe zhvillimit të zonës urbane, por edhe kompleksiteti i projektit, i cili duhet të përmbush të gjitha kërkesat teknike të kërkuara nga përfaqësia e artistëve në komision, nuk mundësonte ndërtimin e godinës në një kohë të shpejtë dhe me infrastrukturë moderne për një teatër bashkëkohor.

Nisur nga interesi për të ndërtuar një godinë bashkëkohore dhe moderne, që plotëson të gjitha kushtet teknike për realizimin e shfaqjeve, e cila t'i shërbejë komunitetit artistik teatror dhe publikut artdashës, Qeveria dhe Bashkia Tiranë vendosën që godina e re e Teatrit Kombëtar të ndërtohet nga shteti si një investim publik.

Për këto arsye, Bashkia e Tiranës do t'i kërkojë qeverisë shqiptare që ta mbështesë financiarisht për realizimin e kësaj vepre ikonike për qytetin dhe vendin tonë. Bashkia Tiranë zotohet se do ta ndërtojë Teatrin e ri Kombëtar në një kohë më të shkurtër kalendarike dhe në përmbushje të të gjitha kërkesave teknike të shprehura nga komuniteti i artistëve në konsultimet publike.

Puna për ndërtimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar do të nisë brenda vitit të 100-vjetorit të shpalljes së Tiranës Kryeqytet të Shqipërisë.”²

12. E ndërsa Bashkia Tiranë, nën pretekstin e mospërfundimit me sukses të procedurave negociuese me shoqërinë sipas ligjit të posaçëm nr. 37/2018 të miratuar për këtë qëllim, bën publik një lajm se po tërhiqet nga projekti fillestar, në datën **8 maj 2020**, në Fletoren Zyrtare nr. 83³, është botuar Vendimi nr. 377, datë 8.5.2020 i Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë”.

13. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtij vendimi, rezulton se në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, Këshilli i Ministrave ka vendosur:

1. *Kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë, me sipërfaqe totale 5 522.7 (pesë mijë*

² Konsulto *link-un*: <https://www.tirana.al/artikull/deklarate-e-bashkise-se-tiranes-12990>

³ Konsulto *link-un*: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/83/43f5fccd-11a9-423e-9bce-ae58f8fe2016>

e pesëqind e njëzet e dy pikë shtatë) m2, me adresë: rruga “S. Toptani”, Tiranë, me qëllim ndërtimin e një godine bashkëkohore dhe me standarde të Teatrit Kombëtar, në konsultim me të gjitha grupet e interesit, sipas hartës kadastrale që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. ***Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë apo t’ua japë në përdorim të tretëve.***

II. Mbi kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e kësaj kërkesë

1. Sipas nenit 131, paragrafi 1, pika shkronja “c)”, është Gjykata kushtetuese që vendos për pajtueshmërinë e **akteve normative të organeve qendrore** dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.

2. Vendimi nr. 377, datë 8.5.2020 i Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë”, është një akt që për nga natyra dhe çështja që trajton, nuk mund të klasifikohet si akt individual (edhe pse kalon pronësinë e një pasurie të identifikuar tek një subjekt po i identifikuar). Ky akt, në fakt është një akt me rregullim të përgjithshëm që përcakton norma me karakter detyrues jo për një rast individual.

3. Ky akt, nuk është akt administrativ individual, në kuptimin që përcakton ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykomit e mosmarrëveshjeve administrative”, apo ligji nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, por është një akt nënligjor normativ, për sa kohë përmban vullnetin e shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron në zbatimin e tij.

4. Në këtë rast, Vendimi nr. 377, datë 8.5.2020 i Këshillit të Ministrave, sipas kuptimit të legjislacionit në fuqi për aktin me karakter individual, nuk rregullon një marrëdhënie konkrete, apo t’u drejtohet një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës. Ky është një akt që trajton dhe urdhëron fatin e **pasurisë pronë publike**, me **një interes të përgjithshëm kombëtar**, ndaj dhe pasojat që prodhon ky akt prekin të gjithë shtetasit e Republikës së Shqipërisë, dhe jo një grup individualisht të përcaktuar.

Ky akt nuk prek një apo disa subjekte të identifikuara apo të identifikueshme, por një numër të pafund subjektësh që nuk identifikohen, praktikisht të gjithë shqiptarët. Përmes këtij akti, vendoset rregullimi i përgjithshëm se kompleksi i godinave të Teatrit Kombëtar do të prishet dhe se të gjithë tashmë, do të duhet të zbatojnë këtë qëllim për ndërtimin e një godine të re.

5. Përveç të tjerave, ky vendim i Këshillit të Ministrave për kalimin në pronësi të kësaj prone me interes kombëtar, kërkon nxjerrjen e akteve të tjera nga organi që përfiton pronësinë (Bashkia Tiranë), të tilla si: akti për prishje, akti për gjetjen e një sipërmarrësi kontraktor, akti për konsultimin me grupet e interesit, akti për hartimin e projektit, akti për lejen e ndërtimit

përkatëse etj.. Të gjitha këto akte që detyrimisht për shkak të qëllimit që përcakton vetë Vendimi nr. 377, datë 8.5.2020 i Këshillit të Ministrave, do të duhet të dalin pikërisht për zbatimin e këtij vendimi dhe përmbushjen e qëllimit të tij, bën që ky vendim i Këshillit të Ministrave të ketë natyrën e një akti normativ me efekte dhe karakter të përgjithshëm, kundërshtimi i të cilit realizohet përmes gjykimit kushtetues.

6. Përmes këtij akti, shqiptarët kudo që janë, urdhërohen të humbasin një pasuri publike me interes të lartë kombëtar, duke humbur kështu me prishjen e tij, elementë që lidhen drejtpërdrejtë me trashëgiminë kulturore dhe identitetin kombëtar.

Pikërisht për këto arsye dhe të tjera që do të shpjegohen në vijim e që lidhen me parimet themelore kushtetuese dhe interesin publik të përgjithshëm që cenon Vendimi nr. 377, datë 8.5.2020 i Këshillit të Ministrave, bën që ky kërkim të jetë nën **juridiksionin kushtetues**.

Kjo është e lidhur edhe me kërkesën që Presidenti i Republikës ka depozituar tashmë në Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin e ligjit nr. 37/2018, ligj i cili nuk është ndryshuar, nuk është shfuqizuar, ndërsa shqyrtimi i kërkesës për kundërshtimin e tij, **është ende në proces dhe nuk ka përfunduar.**

Presidenti i Republikës i sjell në vëmendje të Gjykatës Kushtetuese se,

Ky vendim, për arsyet e parashtruara në këtë kërkesë, vazhdon të bartë qëllimin antikushtetues për cenimin e pasurive që janë të lidhura ngushtësisht me trashëgiminë kulturore kombëtare dhe identitetin kombëtar. Pra është e qartë se, përmes togfjalëshit në pikën 1 të këtij vendimi ku citohet *“me qëllim ndërtimin e një godine bashkëkohore dhe me standarde të Teatrit Kombëtar”*, shoqëruar dhe me togfjalëshin në pikën 2 se, *“Bashkisë Tiranë i ndalohe të ndryshojë destinacionin e pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi”*, **qëllimi për shkatërrimin e godinave aktuale të kompleksit të Teatrit Kombëtar është vendosur dhe urdhëruar në mënyrë të detyruar nga Këshilli i Ministrave, ndërkohë që kryetari i Bashkisë Tiranë dhe Këshilli Bashkiak, mbetet vetëm që ta vendosin në ekzekutim këtë vullnet politik të Qeverisë dhe Kryeministrit.**

Pra në thelb, edhe ky akt i Këshillit të Ministrave - Vendimi nr. 377, datë 8.5.2020 edhe pse referuar formës dhe procedurës së përzgjedhur, mbulohet nën argumentin e një vendimi rutinë të kalimit të së drejtës së pronësisë të një pasurie publike nga pushteti qëndror tek pushteti vendor, në thelb, përmban të njëjtën problematikë kushtetuese dhe të njëjtin rrezik sikundër dhe ligji special nr. 37/2018, që aktualisht është në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese.

Të dy këto akte ligji nr. 37/2018 dhe VKM nr. 377/2020, shprehin qartë të njëjtin qëllim politik: Prishjen e godinave ekzistuese të Teatrit Kombëtar, gjë e cila do të përbënte shkeljen me të rëndë të parimeve kushtetuese që lidhen me identitetin dhe trashëgiminë tonë kombëtare, vlera këto të mbrojtura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe

aktet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë ka aderuar apo i ka ratifikuar. Prandaj këto akte duhen shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, e cila duhet të vendosë sa më shpejt edhe për pezullimin e ekzekutimit të tyre.

Pas bërjes publike dhe hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 377/2020, si dhe nisur nga fakti që qëllimi politik i Këshillit të Ministrave dhe Bashkisë Tiranë lidhet drejtpërdrejtë me të njëjtat pretendime dhe kërkesa që kanë hyrë në fazën e shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese, e cila për shkak të mungesës së kuorumit nuk mundet ta shqyrtojë këtë kërkim, Presidenti i Republikës, menjëherë, më datë 9 maj 2020, ka bërë publike një deklaratë për shtyp⁴, përmes së cilës, ka shprehur qëndrimin e tij, duke kërkuar reflektim nga institucionet e Këshillit të Ministrave dhe Bashkisë Tiranë, të cilat janë dhe palë në procesin e hapur tashmë në Gjykatën Kushtetuese.

Në këtë deklaratë Presidenti i Republikës ka bërë me dije vullnetin e tij se:

“Pasi u njoha me përmbajtjen e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.377, datë 8 maj 2020, botuar me urgjencë në Fletoren Zyrtare nr.83, datë 8 maj 2020, përcjell me forcë këtë mesazh drejtuar autoriteteve shqiptare.

Çdo veprim apo vendim për të cenuar godinat e Teatrit Kombëtar është jashtë çdo logjike të funksionimit të shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit në Shqipëri dhe do të dhunonte në mënyrë kriminale rendin kushtetues, në kundërshtim të plotë edhe me interesin publik dhe kombëtar.

Këshilli i Ministrave dhe Bashkia e Tiranës duhet të mos ndërmarrin asnjë veprim të mëtejshëm që cenon kompleksin e godinave të Teatrit Kombëtar.

Vijimi i kësaj veprimtarie shtetërore për prishjen e godinave të Teatrit Kombëtar në këtë moment, do të dëmtonte rëndë imazhin dhe kredencialet e vendit tonë në arenën ndërkombëtare dhe familjen evropiane, sidomos në kushtet kur objekti i Teatrit Kombëtar në datën 24 mars 2020 është listuar në objektet e trashëgimisë evropiane, duke shënuar kështu udhëtimin evropian të kësaj qendre të kulturës shqiptare dhe identitetit tonë kombëtar.

Organizata ‘Europa Nostra’ e mbështetur nga Këshilli i Evropës dhe Parlamenti Evropian e ka vlerësuar këtë godinë, duke kërkuar ndërprerjen e çdo veprimi mbi të nga institucionet shqiptare⁵.

T’i kundërvihesh një mbështetje të Bashkimit Evropian në Ditën e Evropës, është sinjali më i keq i bashkëpunimit dhe mbështetjes së vlerave për të cilat kemi 30 vite që përpiqemi të përqafojmë.

Çdo veprim i mëtejshëm dhe mungesa e reflektimit mbi këtë çështje e detyron Presidentin e Republikës që në ditët në vijim të paraqesë një kërkesë të re pranë Gjykatës Kushtetuese, për shpalljen antikushtetues jo vetëm të ligjit special nr.

⁴Konsulto *link*-un: <http://president.al/presidenti-meta-reagon-serish-per-ceshtjen-e-teatrit-kombetar-nese-nuk-ka-reflektim-padi-tjeter-ne-gjykatën-kushtetuese/>

⁵Konsulto *link*-un: <https://www.europanostra.org/europe-7-most-endangered-heritage-sites-2020-announced/>

37/2018⁶, por tanimë edhe të Vendimit nr. 377, datë 8 maj 2020 të Këshillit të Ministrave apo të çdo akti tjetër të lidhur me të.

Mbetem shpresëplotë në një reflektim që na bashkon në këto kohë të vështira që po kalon vendi”.

Presidenti i Republikës, po në të njëjtën ditë, më 9 maj 2020, ka publikuar edhe një tjetër qëndrim⁷ në lidhje me çështjen e Teatrit Kombëtar, me këtë përmbajtje:

“Presidenti Meta thekson edhe njëherë se kompleksi i Teatrit Kombëtar mishëron vlerat e identitetit dhe trashëgimisë sonë kombëtare, vlera këto që gëzojnë mbrojtje të veçantë dhe të drejtëpërdrejtë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Këshilli i Ministrave, ditën e djeshme më datë 8 maj, ka vendosur që këtë pasuri kombëtare t’ia kalojë në pronësi Bashkisë Tiranë, me qëllim ndërtimin e një godinë të re të Teatrit Kombëtar. Kjo vendimmarrje në praktikë do të thotë se aktualisht po përdoret një procedurë tjetër ‘ekstra ligjore’ tashmë në përgjegjësinë vetëm të Bashkisë Tiranë, për të prishur godinat e Teatrit Kombëtar.

Ky vendim i Këshillit të Ministrave dhe vullneti i shprehur i Bashkisë Tiranë nuk është në përputhje me funksionimin e shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit, si dhe nuk përkon me vlerat e Bashkimit Evropian, institucionet kulturore të të cilit kanë shprehur vullnetin për mbrojtjen e këtij objekti dhe restaurimin e tij.

Ky vendim i djeshëm i qeverisë me të drejtë ka krijuar një reagim të fortë qytetar, pasi veç të tjerash, merret në një kohë kur vendi po i nënshtrohet gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe masave kufizuese të lirisë së qarkullimit, si dhe në një moment, kur pikërisht kjo çështje ndodhet për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, e cila që prej 3 vitesh nuk është funksionale.

Presidenti Meta thekson se në muajin korrik 2019 ka depozituar në Gjykatën Kushtetuese një kërkesë, e cila do të duhet ta shqyrtojë në themel këtë çështje.

Në këtë proces gjyqësor që duhet të shqyrtohet, është palë si Këshilli i Ministrave, Bashkia Tiranë dhe Ministria e Kulturës, etj., ndaj marrja e një vendimi të tillë në këtë moment rëndon pozitën antikushtetuese të veprimtarisë shtetërore ndaj këtij objekti me rëndësi kombëtare.

Presidenti Meta u kujton të gjithë organeve shtetërore, përfshi këtu dhe Këshillin e Ministrave dhe Bashkisë Tiranë, se njëra prej çështjeve kryesore që pritet të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese nuk ka të bëjë vetëm me faktin nëse ligji special nr. 37/2018 është antikushtetues, por më kryesorja lidhet me detyrimin ligjor që çdo veprim apo vendim shtetëror, që synon apo ndërmerret për prishjen e Teatrit Kombëtar, cenon drejtpërdrejtë parimet themelore kushtetuese të identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kombëtare mbi të cilat qytetarët e Republikës së Shqipërisë kanë vendosur të ngrenë dhe zhvillojnë shtetin e tyre, parime këto të parashikuara nga nenet neni 3, të Kushtetutës.

⁶Konsulto link-un: <http://president.al/presidenti-meta-depoziton-kerkesen-per-shpalljen-antikushtetues-te-ligjit-per-shembjen-e-teatrit-kombetar-ne-gjykatën-kushtetuese/>

⁷Konsulto link-un: <http://president.al/deklarate-e-presidentit-te-republikes-per-ceshtjen-e-teatrit-kombetar/>

Gjithashtu një tjetër çështje që do shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese ka të bëjë me edhe faktin se veprimtaria administrative shtetërore e pushtetit qendror apo lokal, që synon apo ndërmerr veprime për prishjen e Teatrit Kombëtar, bie ndesh me të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim, të mishëruar edhe në Konventën Evropiane të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale dhe Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Në këto kushte, Presidenti i Republikës, në këtë Ditë të Evropës, u bën thirrje autoriteteve shtetërore, se çdo veprim apo vendim për të cenuar godinat e Teatrit Kombëtar është jashtë çdo logjike të funksionimit të shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit në Shqipëri dhe do të dhunonte në mënyrë kriminale rendin kushtetues, në kundërshtim të plotë edhe me interesin publik dhe kombëtar!

Presidenti Meta thekson edhe njëherë se për këtë çështje Këshilli i Ministrave dhe Bashkia e Tiranës, duhet të mos ndërmarrin asnjë veprim të mëtejshëm që cenon Teatrin Kombëtar!

Këto institucione duhet të tregojnë vullnet dhe përkushtim për krijimin e mjediseve në dobi të aktorëve dhe të publikut, duke synuar ndërtimin e godinave të reja funksionale bashkëkohore, por njëkohësisht pa prekur dhe cenuar aspak trashëgiminë e krijuar ndër vite në kompleksin e godinave ekzistuese të Teatrit Kombëtar, pasi një humbje e tillë do të ishte përfundimisht e parikuperueshme në të ardhmen!”

Presidenti i Republikës ka qëndruar në pritje të reflektimit të institucioneve përkatëse dhe ka ndjekur reagimet publike qoftë të kryetarit të Këshillit të Ministrave, ashtu dhe të kryetarit të Bashkisë Tiranë.

Këto dy autoritete përgjatë kësaj jave kanë reaguar publikisht duke shfaqur hapur se qëllimi i tyre politik dhe i unifikuar është i qartë, se nuk tërhiqen nga vullneti për shembjen e godinave të kompleksit ekzistues të Teatrit Kombëtar dhe ndërtimit të një godine të re në truallin e tij.

Kryetari i Bashkisë Tiranë në një intervistë me gazetaren Eni Vasili në emisionin “Open”, në televizionin ‘Top Channel’ të datës 12 maj 2020⁸, ka mbajtur qëndrimin e tij publik shumë të qartë se procedura sipas VKM-së nr. 377/2020 do të ndiqet tashmë nga Bashkia Tiranë, e cila sipas tij ka eksperiencë në këtë drejtim, çka normalisht do të sjellë si pasojë që godinat ekzistuese të Teatrit Kombëtar do të prishen për të ndërtuar një teatër të ri.

Këto deklarata të Kryetarit të Bashkisë, përveçse vijnë në kundërshtim me parimet kushtetuese, kapërcejnë edhe kufijtë e lejuar nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ku sipas nenit 25, bashkitë janë përgjegjëse për zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

⁸ Konsulto *link-un*: <https://www.facebook.com/ErionVeliaj/videos/932034513918253/>

Duke qenë se, pasuria që kalon në pronësi të Bashkisë Tiranë me emërtimin “Teatri Kombëtar”, pra një objekt që lidhet **me interesin e përgjithshëm kombëtar**, dhe jo me vlera të trashëgimisë kulturore me **interes vendor**, **Bashkia Tiranë nuk mundet të ketë në pronësi dhe aq më pak të shprehet për çështjet që kapërcejnë kufijtë e kompetencës dhe juridiksionit vendor që i përkasin sipas ligjit.**

Edhe pse vendndodhja e Teatrit Kombëtar është në kufijtë territorialë të Bashkisë Tiranë sipas ndarjes administrative territoriale të vendit, kjo e fundit nuk mund të përcaktojë qoftë me deklarata publike, apo me akte konkrete, fatin e ekzistencës ose jo, të objekteve që lidhen drejtpërdrejtë me çështje të interesit të përgjithshëm kombëtar. Në këtë këndvështrim, **juridiksioni i Bashkisë Tiranë për të vendosur për pasurinë me emërtimin “Teatri Kombëtar”, është i kufizuar. Për këto lloj pasurish publike, pronësia duhet të qëndrojë në emër të Republikës së Shqipërisë.**

Edhe Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, po në datën 12 maj 2020⁹, në një bashkëbisedim me gazetarët, i pyetur për këtë çështje si dhe për qëndrimin e Presidentit të Republikës, u shpreh se:

“Është një proces për të cilin jam shprehur që prej viteve 1998-1999. Ajo godinë duhet shembur dhe Shqipëria duhet të ketë një teatër të ri kombëtar të denjë për këtë emër. Mezi pres të shoh teatrin e ri kombëtar. Të gjithë kanë të drejtë të kenë opinionet e tyre, por në fund vendos shumica. Ne jemi shumica dhe e kemi marrë këtë vendim edhe nuk shoh se si pakica të caktuara mund të imponohet në vendimmarrje të pushtetit të mandatuar nga populli.”

Kjo qasje publike e autoriteteve më të larta të pushtetit qendror të Kryeministrit dhe të atij vendor në Bashkinë e Tiranë, qartësisht konfirmojnë qëllimin e vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave përmes aktit- Vendim nr. 377, datë 8 maj 2020. Në praktikë kjo vendimmarrje do të thotë se po përdoret një procedurë tjetër “ekstra ligjore”, përmes përgjegjësisë dhe drejtimit vetëm të Bashkisë Tiranë, Kryetari i së cilës i përket së njëjtës forcë politike me qeverinë, për të prishur godinat e Teatrit Kombëtar.

Duke qenë se autoritetet shtetërore të sipërcituara, e kanë shprehur hapur publikisht vullnetin e tyre, vullnet i cili tashmë po reflektohet dhe përmes VKM-së nr. 377, datë 8 maj 2020 dhe që bie ndesh me parimet kushtetuese e që dëmtojnë identitetin dhe trashëgiminë kulturore kombëtare, atëherë Presidenti i Republikës, për argumentet që do të jepen edhe në vijim, ka vendosur që përmes kësaj kërkesë t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe me Marrëveshjet Ndërkombëtare, të Vendimit nr. 377, datë 8.5.2020 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë”.

⁹ Konsulto *link*-un:

-<https://www.oranews.tv/article/rama-si-veliaj-teatri-kombetar-do-te-shembet-vendos-shumica>

-https://www.youtube.com/watch?time_continue=10&v=mqxwGszxG9A&feature=emb_title

Presidenti i Republikës, në ushtrim të kompetencës dhe së drejtës së tij të parashikuar nga Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 134/1/a, ku citohet se Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të Republikës, i drejtohet Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, si i vetmi organ që në zbatim të nenit 131/1/c mund të vendosë për papajtueshmërinë e Vendimit nr. 377, datë 8.5.2020 i Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë” me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.

Kjo kërkesë e re me objekt shfuqizimin si antikushtetues të VKM-së nr. 377/2020 që paraqitet sot për shqyrtim përpara Gjykatës Kushtetuese, shpreh dhe një herë vullnetin e Kreut të Shtetit si përfaqësues i unitetit të popullit se, edhe kërkesa/çështja e ngritur nga Presidenti i Republikës në kërkesën e datës 24 korrik 2019 për shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr. 37/2018, në mbështetje të nenit 51 të ligjit nr. 8577/2000, do të duhet të vijojë të shqyrtohet, **pasi të dy këto akte të kundërshtuara pavarësisht nga organi që i ka nxjerrë, apo vijueshmëria e zbatimit të qëllimit të tyre, janë akte që ndikojnë në ekzistencën e kompleksit të godinave ekzistuese të Teatrit Kombëtar, që paraqet një interes të lartë publik dhe shtetëror të lidhur drejtpërdrejtë me respektimin veç të tjerave, të parimeve themelore kushtetuese.**

E drejta për të vendosur mbi ekzistencën e objekteve dhe pasurisë sonë materiale dhe jomateriale që ndikojnë drejtëpërdrejtë në trashëgiminë dhe identitetin tonë kulturor kombëtar nuk i takon një qeverie apo aq më pak, një kryetari bashkie.

Sovraniteti për çështjet të tilla duhet t`u takojë të gjithë qytetarëve dhe përderisa ky unitet mishërohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në parimet themelore të parashikuara prej saj, atëherë i takon vetëm Gjykatës Kushtetuese për t`u shprehur përfundimisht mbi këtë çështje dhe asnjë institucioni tjetër. Është ky i vetmi institucion që ka për detyrë të shprehet mbi pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare (neni 131 i Kushtetutës).

III.Parimet dhe të drejtat që shkelen përmes aktit objekt kundërshtimi

1. Vendimi nr. 377, datë 8.5.2020 i Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë” është **propozuar dhe miratuar në bazë të nenit 13 dhe 15**, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar.

1.1 Neni 13, i këtij ligji sanksionon se:

“Këshilli i Ministrave cakton organin shtetëror **përgjegjës për administrimin** e çdo njësie të pronës së paluajtshme, duke bërë shënimin përkatës në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.”

1.2 Ndërsa neni 15 “Ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit”, sanksionon se:

*“Këshilli i Ministrave ndryshon **përgjegjësinë e administrimit** nga një organ shtetëror ose ent publik te një tjetër në rastet kur:*

- a) organi përgjegjës nuk administron pronën në përputhje me nenin 13 të këtij ligji;*
- b) ndryshojnë karakteristikat e pronës;*
- c) përdorimi më i dobishëm i pronës mund të realizohet nën administrimin e një organi tjetër shtetëror ose publik.”*

Sa më sipër, nuk është dhënë asnjë shpjegim jo vetëm mbi ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të kësaj pasurie nga Ministria e Kulturës te Bashkia Tiranë, sipas kërkesave të nenit 15 të ligjit nr. 8743/2001, por është vijuar me kalimin e pronësisë së këtij objekti, pa sqaruar më parë se, cilat karakteristika të pronës kanë ndryshuar apo cila është arsyeja që Bashkia Tiranë do të mund të realizojë një përdorim më të dobishëm të pronës, pra të godinave ekzistuese të Teatrit Kombëtar, gjë e cila e bindi Këshillin e Ministrave se ky organ i pushtetit vendor është i aftë që të realizojë nën administrimin e tij një përdorim më të dobishëm.

Nga përmbajtja e VKM-së nr. 377, datë 08.05.2020, objekt kundërshtimi në krahasim me vullnetin politik të shprehur publikisht nga Kryeministri dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë, qëllim i tyre është i qartë jo një përdorim më i dobishëm i së mirës publike, por shembja e godinave ekzistuese të Teatrit Kombëtar.

1.3 Gjithashtu, si bazë ligjore për nxjerrjen e këtij vendimi janë përdorur nenet 3, shkronja “d”, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar. Këto dispozita në mënyrë specifike parashikojnë se:

Neni 3, shkronja “d”- *U transferohen njësitë të qeverisjes vendore pronat që përdoren për realizimin e funksioneve [...] Pronat që përdoren për kryerjen e veprimtarive social-kulturore e sportive.*

Neni 5- *Transferimi i pronës nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore, sipas këtij ligji bëhet në njërin nga format e mëposhtme: **në pronësi ose në përdorim.***

Neni 7- *Në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë, pushteti qendror mund të vendosë kushte dhe kufizime mbi këtë të drejtë. Këto kushte dhe kufizime duhet të jenë vetëm për të siguruar maksimumin e përfitimeve publike ose mbrojtjen e një karakteristike të veçantë të pronës.*

Neni 8- *Kufizime mbi të drejtën e pronësisë janë:*

*a) **Mosndryshim i destinacionit.** Ndalimi i ndryshimit të destinacionit dhe/ose qëllimit të përcaktuar në aktin e transferimit pa miratimin e pushtetit qendror.*

*b) Kushte të veçanta përdorimi. Përdorimi i pronës në mënyrë **që të garantojë ruajtjen e karakteristikave unike të saj.***

c) Kufizimet mbi të drejtën e tjetërsimit dhe të dhënies në përdorim. Për disa prona mund të ndalohet e drejta e tjetërsimit ose e dhënies në përdorim të të tretëve pa

miratimin e pushtetit qendror. Ndalohet tjetërsimi ose ndërrimi i destinacionit të pronave publike, për të legalizuar ndërtime pa leje.

Neni 17- *Transferimi i pronave, sipas këtij ligji, do të përfundojë brenda 24 muajve pas hyrjes së tij në fuqi. Transferime të tjera do të kryhen edhe pas këtij afati, sa herë që do të ketë shtesa të funksioneve të njësisë të qeverisjes vendore. Kryerja e transferimit do të bëhet si vijon:*

a) Jo më parë se afati i përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji dhe jo më vonë se 13 muaj nga data e hyrjes në fuqi të tij, njësitë e qeverisjes vendore paraqesin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që ato kërkojnë t'u transferohen në përputhje me nenin 4 dhe nenet e kreut III të këtij ligji.

b) Brenda 20 muajve nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave, pasi të shqyrtojë kërkesat e paraqitura nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas shkronjës (a) të këtij neni, merr vendim paraprak për listën e pronave që do t'ia transferojë çdo njësi të qeverisjes vendore. Lista e pronave që transferohen përmban kushtet dhe kufizimet që Këshilli i Ministrave vendos për pronat në pajtim me këtë ligj. Lista u njoftohet menjëherë çdo njësi të qeverisjes vendore përkatëse, e cila, brenda 10 ditëve nga dita e njoftimit, e shpall atë publikisht.

c) Jo më vonë se 3 muaj nga data e marrjes së listës së pronave, çdo njësi e qeverisjes vendore mund t'i parashtojë Këshillit të Ministrave kundërshtime për përmbajtjen e listës, sipas shkaqeve të caktuara në nenin 19 të këtij ligji.

ç) Jo më vonë se 24 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Këshilli i Ministrave do të vendosë përfundimisht për transferimin e pronës për të cilën ka kundërshtime nga njësitë e qeverisjes vendore, së bashku me ndonjë kusht ose kufizim që duhet zbatuar në këto prona.

d) Njësitë e qeverisjes vendore, të cilat fillimisht paraqesin listën e pronës sipas nenit 17(a), mund ta kundërshtojnë vendimin përfundimtar të Këshillit të Ministrave para gjykatës së rrethit gjyqësor (seksioni administrativ), sipas nenit 19 të këtij ligji.

dh) Njësitë e qeverisjes vendore, të cilat nuk e parashtojnë listën e pronave sipas nenit 17(a), nuk kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin përfundimtar të Këshillit të Ministrave për transferimin e pronave.

1.4 Po t'i referohemi kartelës së pasurisë së paluajtshme që i bashkëlidhet vendimit nr. 377, datë 8.5.2020 të Këshillit të Ministrave, pasuria që i kalohet në pronësi Bashkisë Tiranë është regjistruar si **pasuri "shtet", pra me pronar Republikën e Shqipërisë** dhe administrator të deritanishëm Ministrinë e Kulturës.

1.5 Ligji nr. 8743/2001, në nenin 3 të tij përcakton se:

"1. I përkasin shtetit dhe bëjnë pjesë në pronat e paluajtshme publike:

[...] b) Zonat historike, arkeologjike dhe kulturore, si dhe parqet me rëndësi kombëtare ose vendore. [...]

3. Janë, gjithashtu, prona të paluajtshme publike, nëse i përkasin shtetit, edhe aktivet e ngurtësuar (ose të trupëzuara), që shërbejnë për kryerjen e shërbimeve publike si:

- rrugët dhe urat, hekurudhat dhe sistemet ndihmëse të lidhura më to;

- infrastruktura aeroportuale;

- sistemet e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë;
 - sistemet e shërbimit të telekomunikacionit dhe të postës;
 - sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm, si dhe të derdhjeve të ujërave të zeza të qendrave të banuara;
 - **ndërtimet me interes të njohur historik, arkeologjik dhe kulturor;**
 - parqet, lulishtet, sheshet publike në qytete e qendra të banuara, **ndërtesat së bashku me oborret që përdoren për shërbime që ofrohen nga shteti për** arsimin, shkencën, **kulturën** dhe sportet, për shërbimin shëndetësor e shoqëror, për institucionet qendrore dhe vendore, si dhe rezidencat qeveritare së bashku me trojet mbi të cilat ngrihen këto prona.
- 4. Pronat e paluajtshme publike tjetërsohen ose jepen në përdorim sipas mënyrave dhe kufijve të përcaktuar me ligje të veçanta.”**

Sa më sipër, në kuptim të ligjit nr. 8743/2001, kompleksi i godinave të Teatrit Kombëtar ka një status të veçantë sipas nenit 3, për shkak se është një kompleks godinash i përdorur historikisht që prej ndërtimit për qëllime kulturore dhe sociale.

Ai kompleks godinash për shkak të interesit dhe trashëgimisë që përmban, nuk është çështje vlerësimi më e një Qeverie apo e një Kryetari Bashkie, por çështje e ndjesisë publike të gjithëpranuar për vlerat artistike dhe kulturore që bart.

Kjo godinë, në kuptim të ligjit nr. 8743/2001, është një **pasuri e paluajtshme publike**, që ka status dhe regjim juridik të ndryshëm nga **pasuritë e paluajtshme shtetërore**.

Sipas pikës 4, të nenit 3, të ligjit nr. 8743/2001, pasuritë e paluajtshme publike mund të tjetërsohet apo jepen në përdorim, vetëm përmes **një ligji të posaçëm**, dhe jo me një vendim të Këshillit të Ministrave. Edhe në rast të trajtimit me ligj të posaçëm qëllimi dhe objektivat e realizimit të tij duhet të respektojnë detyrimisht parimet themelore kushtetuese, interesin publik duke respektuar në çdo rast trashëgiminë dhe identitetin kulturor kombëtar.

Kësisoj, përveç të tjerave, vendimi nr. 377, datë 8.5.2020 i Këshillit të Ministrave është një akt që ka dalë **pa asnjë autorizim ligjor**, pasi as ligji nr. 8743/2001 dhe as ligji nr. 8744/2001, **për pasuri të kësaj natyre, nuk autorizojnë nxjerrjen e një vendimi të Këshillit të Ministrave me këtë përmbajtje për transferimin e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme publike. Pikërisht ky fakt, bën që ky akt të ketë një defekt kushtetues, duke cenuar hapur nenin 118, paragrafi 2 të Kushtetutës.**

1.6 Sa më sipër, jo vetëm **baza ligjore nuk autorizon kryerjen e kalimit të pronësisë** nga Këshilli i Ministrave për njësitë e qeverisjes vendore (por vetëm kalimin në përgjegjësi administrimi), por është përdorur si autorizim ligjor neni 17 i ligjit nr. 8744/2001, dispozitë e cila përmban afate dhe procedura transferimi të pronësisë që lidheshin me momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji **apo me shtimin e funksioneve të Bashkisë Tiranë, çka nuk ka ndodhur në rastin konkret.**

Në këto kushte, Vendimi nr. 377, datë 8.5.2020 i Këshillit të Ministrave, për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pasurisë me emërtimin “Teatri Kombëtar”, përveçse konstatohet se është bërë në kundërshtim me kërkesat dhe procedurën ligjore, qëllimin në thelb të tij, e ka të njëjtë me atë të deklaruar dhe në ligjin nr. 37/2018, për vijimin e projektit të shembjes së teatrit, duke e bërë të ketë drejtpërdrejtë implikime papajtueshmërie me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, objekt i këtij kërkimi nga Presidenti i Republikës.

Qëllimi është shprehur posaçërisht që në pikën 1 të Vendimit nr. 377, datë 8.5.2020 i Këshillit të Ministrave, kur Këshilli i Ministrave ka vendosur kalimin në pronësi të kësaj pasurie Bashkisë Tiranë, me qëllimin e posaçëm e të shprehur:

“ndërtimin e një godine bashkëkohore dhe me standarde të Teatrit Kombëtar, në konsultim me të gjitha grupet e interesit, sipas hartës kadastrale që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”

1.7 Ky qëllim siç u theksua edhe më sipër, bie ndesh me parimet kushtetuese të mbrojtjes së tashëgimisë dhe identitetit kulturor kombëtar, të parashikuar në nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se:

*“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, **identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare**, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat **janë baza e këtij shteti**, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”.*

Këto vlera dhe parime kushtetuese kërkojnë që në një rend demokratik, shteti të ketë përgjegjësinë fillestare që të ruajë të gjitha ato asete të pasurisë së paluajtshme ose jo, të cilat lidhen, shfaqin, apo mishërojnë trashëgiminë kulturore dhe historike të së shkuarës që bashkarisht formojnë atë që quhet identitet kulturor dhe social. Ndaj për respektimin e këtij parimi është detyrë e organeve shtetërore që të marrin të gjitha masat që të bëjnë çdo përpjekje për ta vlerësuar drejtë dhe sa më objektivisht kur vendimmarrje të tilla që prekin objekte të kësaj rëndësie, të orientohen drejt ruajtjes e jetëgjatësisë. Objekte si Teatri Kombëtar kanë përcjellë dhe përcjellin brez pas brezi historinë dhe zhvillimin shoqëror të vendit tonë.

Çdo forcë politike që qeveris vendin, edhe përse mund të përfaqësojë një shumicë të caktuar politike, sërish nuk mund ta vlerësojë veten të aftë dhe nuk legjitimohet se përfaqëson vullnetin e të gjithë popullsisë për çështje që lidhen me ekzistencën e objekteve që paraqesin dhe mishërojnë drejtpërdrejtë trashëgiminë tonë kombëtare, siç është rasti i godinave të Teatrit Kombëtar. Prandaj në praktikën e një qeverisje demokratike dhe të përgjegjshme, sulmi i një shumice politike qeverisëse për shkatërrimin e këtyre pasurive materiale apo jomateriale, konsiderohet si shprehje e vullnetit të një pakice që për çdo arsye nuk ka legjitimitet për të vendosur për çështje kaq madhore që paraqesin interes të lartë publik në nivel kombëtar.

Referuar këtij arsyetimi, kalimi në pronësi të Bashkisë Tiranë, një organ ky i pushtetit vendor, të godinave të Teatrit Kombëtar, me qëllim të paracaktuar se këto godina do të prishen, përbën cenim të drejtpërdrejtë të parimeve kushtetuese të mbrojtura nga neni 3 i Kushtetutës me pasojë dëmtimin e parikuperueshëm të identitetit dhe trashëgimisë sonë kombëtare.

Për këtë arsye, Vendimi nr. 377, datë 8 maj 2020, i Këshillit të Ministrave është antikushtetues dhe si i tillë, duhet shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, e cila paraprakisht duhet të shqyrtojë dhe kërkesën për pezullimin e çdo veprimtarie të Bashkisë Tiranë, që ka për synim prishjen e godinave ekzistuese të Teatrit Kombëtar.

1.8 Vendimi nr. 377, datë 8 maj 2020, i Këshillit të Ministrave bie ndesh edhe me parimet e ligjit nr. 8743/2001, të cituara në nenin 12 të tij, që përcakton se parimet kryesore të administrimit të pronës së paluajtshme publike janë:

- *ruajtja dhe garantimin e interesit publik;*
- *ruajtja e karakteristikave dhe të vlerave unike të pronës.*

Përmes Vendimit nr. 377, datë 8 maj 2020, të Këshillit të Ministrave është i qartë vullneti i shprehur i Qeverisë dhe Kryetarit të Bashkisë Tiranë, për prishjen dhe shkatërrimin e kësaj prone publike (kompleksit të godinave të Teatrit Kombëtar) dhe vlerave unike që ky kompleks ka, dhe jo për ruajtjen e karakteristikave të tij.

2. Në kërkesën e Presidentit të Republikës të datës 24 korrik 2019, drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkesë që synonte mbrojtjen e këtyre parimeve në raport me moscenimin e godinave të Teatrit Kombëtar, Presidenti i Republikës, përpos argumenteve se si ligji nr. 37/2018 i miratuar në datë 20.09.2018 objekt shqyrtimi, shkelte parimet e “barazisë përpara ligjit” dhe “lirisë së veprimtarisë ekonomike të shtetasve”, parime këto të cilat gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga Kushtetuta, **ka vënë theksin në faktin se:**

- ligji nr. 37/2018, miratuar në datë 20.09.2018 nuk ishte në harmoni me parimet themelore kushtetuese të identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kombëtare apo me objektivat sociale, mbi të cilat qytetarët e Republikës së Shqipërisë kanë vendosur të ngrenë dhe zhvillojnë shtetin e tyre. (neni 3, 59 pika 1, germa “g” e Kushtetutës).

2.1 Në këtë rast, për shkak të natyrës së çështjes, rëndësisë kombëtare të saj, qëllimit të shprehur nga Këshilli i Ministrave përmes VKM-së nr. 377/2020 objekt kërkesë, si dhe sjelljes publike të përfaqësuesve më të lartë të institucioneve qendore dhe vendore, është e nevojshme të përsëritet sërish se edhe për këtë kërkim të ri qëndrojnë të njëjtat argumente si mbi antikushtetutshmërinë e Ligjit nr. 37/2018.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 3 të saj, parashikon:

*“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, **identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare**, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë.”*

2.2 Populli Shqiptar ka vendosur trashëgiminë kombëtare si një nga parimet themelore, mbi bazën e të cilit ngrihet dhe funksionon shteti. Nëpërmjet institucioneve të tij, nga ai më i larti në hierarkinë shtetërore deri tek institucioni më i ulët i administrimit të funksionit publik, shteti ka për detyrë ta respektojë dhe ta ruajë këtë parim, si gjithë parimet e tjera të parashikuara në Kushtetutë.

2.3 Kompleksi i godinave të Teatrit Kombëtar, për 80 vite të funksionimit në dimensione të ndryshme, ka krijuar kujtesën e tij dhe e bën atë padyshim përfaqësues të denjë të historisë kulturore, artistike, arsimore, sociale, albanologjike dhe politike të shtetit shqiptar; pra, të trashëgimisë kombëtare, e cila në këtë këndvështrim është pronë e të gjithëve dhe pikërisht për këto arsye gëzon mbrojtje të drejtpërdrejtë nga Kushtetuta.

2.4 Për këtë çështje qeveria shqiptare dhe Bashkia Tiranë duhet të tregojnë përkushtimin e tyre për krijimin e mjediseve në dobi të aktorëve dhe të publikut, patjetër edhe duke synuar ndërtimin e godinave të reja funksionale bashkëkohore, **por njëkohësisht, pa dëmtuar aspak trashëgiminë e krijuar ndër vite në kompleksin e godinave ekzistuese të Teatrit Kombëtar, pasi një humbje e tillë do të ishte përfundimisht e parikuperueshme në të ardhmen.**

2.5 Presidenti Republikës vlerëson edhe një herë se në lidhje me këto çështje kaq të ndjeshme, të gjitha argumentet duhet të ishin ballafaquar vetëm me studime shteruese shkencore, teknike dhe ligjore në ruajtje të trashëgimisë dhe vlerave historike kombëtare, përpara se të kalohej në një vendimmarrje të tillë.

2.6 Kompleksi aktual i godinave të Teatrit Kombëtar, sipas mendimit të një pjese të mirë të bashkësisë së aktorëve, të studiuesve, akademikëve, historianëve, arkitektëve, inxhinierëve duhet ruajtur dhe mirëmbajtur, pasi vlerat e trashëgimisë dhe identitetit kulturor që ky kompleks ndërtimor ka krijuar ndër vite nëpërmjet zhvillimit historik të artit dhe kulturës shqiptare, janë të jashtëzakonshme për identitetin kombëtar.

3. Në rastin konkret, **qëllimi i shprehur në Vendimin nr. 377, datë 8.5.2020 të Këshillit të Ministrave në vetvete është antikushtetues**, duke vënë Bashkinë Tiranë tashmë nga pozita e drejtimit të grupit të negocimit të një kontrate me një subjekt privat për prishjen e Teatrit Kombëtar dhe ndërtimin e një Teatri të ri, **në autoritetin kontraktor që me fonde publike do të duhet të përmbushë detyrën apo qëllimin politik të ngarkuar posaçërisht nga pika 1, e VKM-së nr. 377/2020.**

3.1 Pra, pavarësisht llojit të aktit normativ të nxjerrë këtë herë, **jemi para të njëjtit qëllim, atë të prishjes së godinës ekzistuese të Teatrit Kombëtar**, qëllim për të cilin u vu në lëvizje Gjykata Kushtetuese në kërkesën e parë. **Ndërkohë që, Teatri Kombëtar, është një godinë që përmban të mishëruara vlera të rëndësishme kulturore dhe historike për vendin tonë.**

3.2 Në këtë rast është qartësisht e dallueshme se **qëllimi i pushtetit qendror dhe vendor nuk është mbrojtja e këtyre vlerave.** Nëse do të ishte, siç dhe do të duhet në fakt, atëherë Këshilli i Ministrave do të përcaktonte ruajtjen, restaurimin, mirëmbajtjen, sipas standardeve të duhura bashkëkohore të këtyre godinave, si kusht i veçantë për t'u përdorur nga Bashkia Tiranë, por kurrësi prishjen e tyre.

Nëse Këshilli i Ministrave do të kishte për qëllim respektimin e vlerave të godinës së Teatrit Kombëtar, në përmbushje të detyrimit Kushtetues, atëherë si kushte për Bashkinë Tiranë, mund të ishin përfshirë:

Përdorimi i pronës në mënyrë që të garantojë ruajtjen e karakteristikave unike të saj, përfshirë kufizimin specifik mbi të drejtën e tjetërsimit dhe të dhënies në përdorim, duke parashikuar ndalimin e të drejtës së tjetërsimit ose e dhënies në përdorim të të tretëve pa miratimin e pushtetit qendror.

Kjo mungesë vullneti e Këshillit të Ministrave, shkon në të njëjtën linjë me qëllimin fillestar të tyre për shembjen e godinave.

3.3 Ndërkohë që për një pjesë të vlerave unike të këtyre godinave, vetë Bashkia Tiranë në faqen zyrtare, bën një përshkrim të Teatrit Kombëtar si një godinë që:

“Teatri Kombëtar’ u ndërtua nga italianët në vitin 1941 si qendër komplekse kulturore: Kinema- Teatër ‘Savoja’. Për kohën ishte kinema – teatri më luksoz në Shqipëri, me 800 vende (plateja dhe lozha). Në vitin 1943 u riemërtua ‘Kosova’. Pas çlirimit, në vitin 1945, këtu u zhvillua gjyqi i parë ndaj kundërshtarëve të regjimit komunist. Më vonë në këtë ndërtesë u vendos teatri i parë profesionist shqiptar i quajtur ‘Teatri Popullor’ dhe që atëherë ka shërbyer si teatër. Sot mban emrin ‘Teatri Kombëtar’”¹⁰.

4. Qëllimi i Vendimit nr. 377, datë 8.5.2020 të Këshillit të Ministrave, njësoj si ligji nr. 37/2018, bie ndesh me parimet e **Konventës Evropiane të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale**, miratuar në Paris në vitin 2003, duke bërë kështu që veprimtaria legislative të bjerë ndesh edhe me të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim.

4.1 Rikujtojmë se, me ligjin nr. 9490, datë 13.03.2006, Kuvendi i Shqipërisë ka ratifikuar konventën “Për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”, e miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën,

¹⁰Konsulto *link*-un: <https://www.tirana.al/pikat-e-interesit/atraksione-ne-tirane/teatri-kombetar>

“UNESCO”, në Paris në datën 17 tetor 2003. Me ratifikimin dhe botimin e saj në “Fletoren Zyrtare”, dispozitat e kësaj konvente janë bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe zbatimi i normave të saj, ka epërsi mbi legjislacionin vendas dhe, sidomos, mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

4.2 Në nenin 2 të kësaj konvente parashikohet, veç të tjerash, se:

“Me ‘trashëgimi kulturore jomateriale’ kuptohen: praktikat, paraqitjet, shprehjet, njohuritë dhe dihebërja (savoir-faire), si dhe veglat, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore që bashkëshoqërojnë ato, që bashkësitë, grupet dhe, kur është rasti, individët, i pranojnë si pjesë përbërëse të trashëgimisë së tyre kulturore. Kjo trashëgimi kulturore jomateriale, përcjellë brez pas brezi, është rikrijuar në vijimësi nga bashkësitë dhe grupet në funksion të mjedisit të tyre, të ndërveprimit të tyre me natyrën dhe të historisë së tyre, dhe u jep atyre një ndjenjë identiteti dhe vazhdimësie, duke ndihmuar kështu për nxitjen e respektit për diversitetin kulturor dhe të krijimtarisë njerëzore.”.

4.3 Gjithashtu, në dispozitat vijuese të nenit 3 të Konventës përcaktohet:

“Trashëgimia kulturore jomateriale”, siç është përcaktuar në paragrafin 1, shfaqet sidomos në traditat dhe shprehjet gojore, përfshirë këtu edhe gjuhën si vektor i trashëgimisë kulturore jomateriale; artet e shfaqjes (spektaklit); praktikat sociale, ritualet dhe ngjarjet festive [...]”.

4.4 Ndërkohë, në nenet 11 dhe 13 të po kësaj Konvente përcaktohet se roli dhe detyra e shtetit palë të kësaj Konvente është që të sigurohet:

“ruajtja, zhvillimi dhe vënia në pah e trashëgimisë kulturore jomateriale, e pranishme në territorin e tij, ku çdo shtet palë, veç të tjerash, të përpiqet që:

- të nxisë studime shkencore, teknike dhe artistike, si dhe metodologji kërkimore për një ruajtje të efektshme të trashëgimisë kulturore jomateriale, në veçanti të trashëgimisë kulturore jomateriale në rrezik;*
- të miratojë masat ligjore, teknike, administrative dhe financiare përkatëse me synim favorizimin e krijimit ose të forcimit të institucioneve për formimin në administrim të trashëgimisë kulturore jomateriale, si dhe përcjelljen e kësaj trashëgimie përmes forumeve dhe hapësirave të destinuara për paraqitjen dhe shprehjen e saj.”*

4.5 Gjithashtu, në nenin 14 të kësaj Konvente përcaktohet si detyrim i shtetit palë, pra edhe i Shqipërisë, e cila e ka ratifikuar këtë Konventë, që të përpiqet me të gjitha mjetet përkatëse për të promovuar edukimin për mbrojtjen e hapësirave natyrore dhe të vendeve historike, ekzistenca e të cilave është e nevojshme për shprehjen e trashëgimisë kulturore jomateriale.

IV. Mbi rëndësinë e veçantë dhe interesin e lartë publik të pasurisë me emërtimin “Teatri Kombëtar”

1. Siç edhe është parashtruar në kërkesën e parë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kompleksi aktual i godinave të Teatrit Kombëtar dhe veprimtaria artistike dhe sociale e krijuar aty, në ndërveprim me historinë dhe kohën, i japin njëra-tjetrës në mënyrë të përbashkët një ndjenjë identiteti dhe vazhdimësie të krijimtarisë njerëzore ndër vite, dhe përbëjnë atë që në vetvete mund të konsiderohet trashëgimi kulturore jomateriale.

2. Ekzistenca e këtyre godinave të kompleksit të Teatrit Kombëtar, është pjesë e pandashme edhe e trashëgimisë kulturore jomateriale, pasi në këtë hapësirë është prodhuar ndër vite art skenik, duke kultivuar me dekada vlerat më sublime të kulturës shqiptare në mbarë hapësirën shqiptare, që përbëjnë trashëgimi kulturore.

3. Sipas përcaktimeve edhe të Konventës “Për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”, koncepti i trashëgimisë kulturore dhe pasurive pjesë të saj, nuk lidhet domosdoshmërisht me ato pasuri apo pjesë të kësaj trashëgimie, që janë njohur ligjërisht si të tilla.

Në rastin konkret, **mosnjohja në terma ligjore të Teatrit Kombëtar, si pasuri pjesë e trashëgimisë kulturore, tashmë është e qartë që është bërë me qëllimin e evidentuar fillimisht në miratimin e ligjit nr. 37/2018.**

Edhe sot, rreth dy vite më pas, ky qëllim vijon të ketë interes për propozuesit (Këshillin e Ministrave) duke bërë që të ndiqet **një rrugë ndryshe në arritjen e të njëjtit qëllim për prishjen e Teatrit Kombëtar.**

4. Vendimi nr. 377, datë 8.5.2020, i Këshillit të Ministrave, bie ndesh edhe me parimet e mbrojtura nga Kushtetuta dhe nga Konventa, ndaj ai **duhet të deklarohet i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë**, pasi ai, përveçse bie ndesh me:

- **nenin 118 të Kushtetutës**, si një akt që duhet të ishte nxjerrë në përputhje me rregullat, procedurat dhe parimet e përcaktuara nga ligji;
- bie ndesh, ndër të tjera, edhe me **nenin 5 të Kushtetutës**, i cili parashikon se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.

5. Këshilli i Ministrave përmes VKM-së nr. 377/2020, i jep rrugë prishjes së godinave të Teatrit Kombëtar këtë herë nga Bashkia Tiranë, pa një studim të mirëfilltë shkencor për një ruajtje të efektshme të kësaj trashëgimie jomateriale, ndërkohë që konventa parashikon se shteti palë duhet të miratojë: masat ligjore, teknike, administrative dhe financiare përkatëse me synim favorizimin e krijimit ose të forcimit të institucioneve për formimin në administrim të trashëgimisë kulturore jomateriale, si dhe përcjelljen e kësaj trashëgimie përmes forumeve dhe hapësirave të destinuara për paraqitjen dhe shprehjen e saj.

6. Mbrojtja e kësaj trashëgimie kërkon që mjediset, në të cilat ajo është krijuar, të forcohen, jetësohen edhe më shumë, pasi janë të lidhura me kujtesën që lidhet me vendin ku ato janë krijuar, pra me godinat, të cilat nëse prishen dhe nuk ekzistojnë më, përbëjnë një rrezik që kujtesa e veprimtarisë kulturore dhe artistike e lidhur me to të humbasë.

7. Ky është një argument i fortë që gjen mbështetje jo vetëm në parashikimet e neneve të Konventës mbi Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore jo Materiale, por në pjesën hyrëse (preambulën) e kësaj konvente ku citohet se, **trashëgimia kulturore jomateriale dhe trashëgimia materiale kulturore dhe natyrore janë të ndërvarura nga njëra-tjetra.**

8. Shqetësimi për vijimin e procedurës që vlerësohet tërësisht antikushtetuese, është përcjellë nga shumë aktorë, përfshirë së fundmi edhe nga Presidenti Ekzekutiv i Lëvizjes për Mbrojtjen e trashëgimisë kulturore “Europa Nostra”, lëvizje kjo që ka bërë thirrje për të mbrojtur “*të çmuarin Teatër Kombëtar*”, që është nominuar si pjesë e fushatës së shoqërisë civile në Evropë, për mbrojtjen e vendndodhjeve më të rrezikuara për vitin 2020 .

9. Organizata “Europa Nostra” e mbështetur nga Këshilli i Evropës dhe Parlamenti Evropian e ka vlerësuar këtë godinë, duke kërkuar ndërprerjen e çdo veprimi mbi të nga institucionet shqiptare¹¹. T’i kundërvihesh një mbështetjeje të Bashkimit Evropian që synon vetëm ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, është sinjali më i keq i bashkëpunimit dhe mbështetjes së vlerave për të cilat kemi 30 vite që përpiqemi të përqafojmë.

10. Presidenti i Republikës, thekson edhe një herë se nëse Teatri Kombëtar do të cenohej si godinë para vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës, atëherë pasojat do të ishin të parikuperueshme. Kjo bën të domosdoshme që të vendoset pezullimi i çdo veprimtarie apo akti që cenon godinat e Teatrit Kombëtar pezullim ky që duhet zgjasë derisa vendimi i Gjykatës Kushtetuese të marrë fuqi.

11. Ndërkohë Institucionet shtetërore duhet t’u përmbahen detyrimeve të sanksionuara në Kushtetutë dhe në të drejtën ndërkombëtare, zyrtarët e të gjitha niveleve duhet të ushtrojnë në mirëbesim, në mënyrë të arsyeshme pushtetin që u është dhënë, brenda qëllimit për të cilin ky pushtet u është akorduar, pa kaluar kufijtë e kompetencave të tilla, duke garantuar në çdo vendimmarrje mbrojtje të mjaftueshme të parimeve, të drejtave dhe lirive të mbrojtura nga Kushtetuta.

Vetëm kështu mund të garantohet një shtet i së drejtës, që i jep përparësi ligjshmërisë së praktikave qeveritare apo vendore. Praktika këto që nuk lejojnë veprime autoritare të njëanshme, në dëm të interesave kombëtare.

¹¹Konsulto *link*-un: <https://www.europanostra.org/europe-7-most-endangered-heritage-sites-2020-announced/>

V. Kërkimet për Gjykatën Kushtetuese

Për gjithë sa u parashtrua më sipër, **Presidenti i Republikës**, në mbështetje të nenit 131 pika 1, germa “c”, 134 pika 1, germa “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 49/1, 50/1 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, **parashtron këtë kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese me qëllim që në përfundim të shqyrtimit, të vendosë:**

- **Shfuqizimin** si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe me Marrëveshjet Ndërkombëtare **të Vendimit nr. 377, datë 8.5.2020** i Këshillit të Ministrave “*Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin ‘Teatri Kombëtar’, në zonën kadastrale 8150, Tiranë*”.
- **Pezullimin e zbatimit të Vendimit nr. 377, datë 8.5.2020** i Këshillit të Ministrave “*Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin ‘Teatri Kombëtar’, në zonën kadastrale 8150, Tiranë*”, **apo të çdo akti apo veprimi që buron prej tij**, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese mbi këtë çështje dhe çështjen në shqyrtim që lidhet me ligjin nr. 37/2018 ‘Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës’ me objekt ‘Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar’”, **të hyjë në fuqi.**

Vendimmarrja e pakonsultuar e Këshillit të Ministrave, këtë herë duke vendosur kalimin e pronësisë mbi pasurinë me emërtimin “Teatri Kombëtar”, dhe duke përcaktuar shprehimisht në këtë vendim që kalimi i pronësisë bëhet **“për të ndërtuar një godinë të re”**, bëjnë që të jemi para nevojës imediate jo vetëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare, por dhe mbrojtjen e interesit të përgjithshëm publik.

Ndaj parashtrohet kjo kërkesë për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së këtij vendimi në raport me parimet themelore që mbron Kushtetuta e vendit tonë.

Rreziku për shkaktimin e një dëmi ndaj interesit publik, në rast të mospezullimit të efekteve të vendimit nr. 377, datë 8.5.2020 i Këshillit të Ministrave, për shkak të qëllimit dhe kushtit antikushtetues që ai ka, këtë herë është akoma më i madh me kalimin e pronësisë së kësaj pasurie Bashkisë Tiranë, pasi ligji nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar, me ndryshimet e pësuara **me ligjin nr. 38/2019**, në nenin 54, **ka krijuar për Bashkinë hapësirë ligjore për miratimin e dhënies në përdorim të pronave të tretëve ose dhënien për zhvillim të pronës nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte private.**

Kjo hapësirë, pa asnjë procedurë dhe kriter, mbart të njëjtin rrezik që paraqiste ligji nr. 37/2018, duke bërë që të ketë një mekanizëm të ri në shkelje të të gjitha parimeve për barazinë para ligjit dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike të shtetasve. Vetëm se **tashmë jo më me një Komision, siç përcaktonte ligji nr. 37/2018, por direkt përmes strukturave të Bashkisë Tiranë.**

Në përfundim, duam të sjellim në vëmendje të Gjykatës Kushtetuese se, **mosvijimi i efekteve të ligjit nr. 37/2018** “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe

lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”, që pret shqyrtimin në Seancë Plenare, në dijeninë tonë, nuk është njoftuar përmes akteve zyrtare, por vetëm përmes deklaratave publike, të sipërcituara në këtë kërkesë.

Në çdo rast, edhe sikur Kuvendi të ndërmarrë iniciativë për shfuqzimin apo ndryshimin e ligjit nr. 37/2018, sërish çështja trajtohet sipas nenit 51, të ligjit nr. 8577/2000, që përcakton se:

“1. Gjatë shqyrtimit të kërkesave të parashikuara nga nenet 49 e 50 të këtij ligji, Gjykata Kushtetuese vlerëson:

a) përmbajtjen e ligjeve dhe të akteve normative;

b) formën e ligjeve dhe të akteve normative;

c) procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të tyre.

2. Kur një ligj ose akt normativ ose pjesë të tij, që janë objekt shqyrtimi para Gjykatës Kushtetuese, shfuqizohen ose ndryshohen para se Gjykata Kushtetuese të marrë vendim, gjykimi pushohet, me përjashtim të rasteve kur ajo çmon se gjykimi duhet të vazhdojë për shkak të një interesi publik ose shtetëror.”

Në këtë rast, shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata Kushtetuese mbi antikushtetutshmërinë e ligjit nr. 37/2018, edhe pse mundet që palët e interesuara në këtë gjykim të pretendojnë pushimin e efekteve juridike të tij, sërish **duhet të vijojë bashkarisht me shqyrtimin e kësaj kërkesë** për antikushtetutshmërinë e Vendimit nr. 377, datë 8.5.2020 i Këshillit të Ministrave. **Kjo jo vetëm për shkak të interesit të lartë publik që paraqet Teatri Kombëtar, si pjesë e trashëgimisë sonë kombëtare, por edhe për faktin se vetë ligji nr. 37/2018, përmes procedurave dhe kriterëve antikushtetuese që përcakton, ka sjellë njëkohësisht dëm financiar në buxhetin e shtetit, jo vetëm përmes kostos administrative të punës së komisioneve që janë ngritur sipas tij, por edhe për marrjen e ekspertizave të specializuara nga konsulentë të jashtëm të përzgjedhur sipas procedurave të përshpejtuara.**

Presidenti i Republikës, në ushtrim të kompetencës së tij kushtetuese, parashtron kërkesën që kjo çështje të shqyrtohet me përparësi të veçantë dhe emergjencë, sapo kjo gjykatë, në respekt të frymës dhe kërkesave të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ketë të mundur shqyrtimin e kërkesave në seancë plenare.

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 45/1 të ligjit nr. 8577/2000, parashtron kërkesën e menjëhershme për pezullimin e zbatimit të Vendimit nr. 377, datë 8.5.2020 i Këshillit të Ministrave “*Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë*”, pasi siç po evidentohet në mënyrë të qartë dhe publikisht nga Kryeministri dhe Kryetari i Bashkisë ekzistojnë të gjitha mundësitë dhe rreziqet që Bashkia Tiranë, duke zbatuar këtë akt antikushtetues dhe qëllimin e shprehur të tij, që bie në kundërshtim me interesin publik, të realizojnë prishjen, apo dëmtimin e kompleksit të godinave të Teatrit Kombëtar, duke sjellë kështu pasoja të rënda, të pariparueshme për interesin publik shtetëror dhe për trashëgiminë kulturore kombëtare.

Ky pezullim duhet të vendoset dhe të zgjasë për aq kohë sa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese mbi këtë çështje, do të hyjë në fuqi.

Në zbatim të nenit 42 të ligjit nr.8577/2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese*”, i ndryshuar, i parashtrijmë gjithashtu Gjykatës se, i gjithë dokumentacioni shkresor i krijuar apo i administruar prej palëve të interesuara Bashkia Tiranë, Ministria e Kulturës, Ministria e Ekonomisë dhe Këshilli i Ministrave, që ka lidhje me çështjen është i nevojshëm për shqyrtimin e saj dhe duhet të bëhet pjesë e këtij shqyrtimi kushtetues.

Bashkëlidhur i paraqesim Gjykatës Kushtetuese kopjen të dokumenteve dhe materialeve, renditur sipas shtojcës 1, që shoqëron këtë kërkesë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META